

# Revista HÖNA

QENDRAT E  
REHABILITIMIT  
TË BAZUAR  
NË BASHKËSI  
RBB

Të  
Drejtat

Prindërimi

Storie  
Suksesi

Sport &  
rekreacion

HULUMTIME

SHËNDETI

HÖNA

 **HANDIKOS**  
SHOQATA E PARAPLEGJINËVE DHE E PARALIZËS SË FËMIJËVE TË KOSOVËS  
ASSOCIATION OF PARAPLEGICS AND PARALYSED CHILDREN OF KOSOVA  
UDRUŽENJE PARAPLEGIČARA I DEĆE PARALIZI KOSOVA



Save the Children

 Sweden  
Sverige

VOLUMI 1

## Çka është Revista HËNA ?

Revista "HËNA" është krijuar me qëllim të avokimit për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë, përmes së cilës promovohen aktivitetet që fëmijët realizojnë në kuadër të HANDIKOS, duke përfshirë komunën e Prishtinës, Ferizajt, Gjakovës dhe Mitrovicës. Revista përditësohet dhe publikohet në çdo tre muaj, për të interesuarit.



HËNA – Grup jo formal avokues i fëmijëve me aftësi të kufizuara, i cili që nga themelimi ka për mision të garantoj të drejtat e fëmijëve për fëmijët me aftësi të kufizuara. HËNA përfaqëson nevojat e fëmijëve në nivel lokal dhe qendror, për më tepër është aktivisht i përfshirë në të gjitha proceset e HANDIKOS.

## Çka është HANDIKOS?

HANDIKOS është organizatë jo qeveritare, që për mision ka të arrijë ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme në jetën e personave me aftësi të kufizuara, përmes përfaqësimit, mbrojtjes së të drejtave dhe përkrahjes së tyre. Pjesëmarrja; Punësimi; Edukimi & Trajnimi; Mirëqenia Sociale; Shëndeti janë objektivat strategjike të HANDIKOS të cilat synon t'i arrij përmes avokimit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.



Çdo fëmijë  
është unik!



Dashuri e  
barabartë!



*Every child  
begins the  
world again*



# Qendrat e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi - **RBB**

## RBB - Prishtinë

- **15 fëmijë** me aftësi të kufizuara kanë pranuar mbështetje virtuale individuale në zhvillimin e tyre fizik dhe social;
- **15 prindër** të fëmijëve janë mbështetur në implementimin e planit PORTAGE;
- Janë shpërndarë **10,000 maska** në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara përgjatë **COVID-19**;
- Janë krijuar **61 video** udhëzues për mbështetjen e fëmijëve në shtëpi;
- Është finalizuar Udhëzimi Administrativ për Pajisje Ndhmëse në kuadër të **Ligjit 05/I-067**;
- Më shumë se **150 pajisje** ndihmëse janë shpërndarë (karroca, paterica, shëtitore);

## RBB - Gjakovë

- 54 (34 D dhe 20 V)** fëmijë me aftësi të kufizuara kanë pranuar mbështetje virtuale individuale dhe grupore në zhvillimin e tyre fizik dhe social; ←
- 50 (47 B dhe 3 G)** prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë pranuar këshilla psikologjike, logopedi, fizio/ergo terapi dhe edukim jo formal; ←
- 85 persona** me aftësi të kufizuara janë pajisur me pako higjienike dhe ushqimore; ←
- Janë shpërndarë **59 pajisje** ndihmëse (shtretër, karroca, paterica); ←
- Më shumë se **500 persona** janë pajisur me maska, dezinfektues dhe doreza për mbrojtjen nga **COVID – 19**; ←

## RBB - Ferizaj

- **38 fëmijë (26M dhe 12F)** janë integruar në kuadër të programeve të Qendrës në këtë periudhë, përderisa **10 fëmijë (5M dhe 5F)** janë regjistruar në shkollë;
- **15 prindër (8F dhe 7M)** të fëmijëve me aftësi të kufizuar kanë formuar grupin avokues 'Zëri ynë' i cili për qëllim ka të avancoj situatën e fëmijëve;
- Janë shpërndarë **95 pako** ushqimore dhe higjienike;
- Janë shpërndarë më shumë se **22 pajisje** ndihmëse (karroca, shëtitore);

## RBB - Mitrovicë

**Dy (2) persona (2G)** me aftësi të kufizuar kanë filluar periudhën e tyre provuese, ndërsa një person (**1D**) ka filluar punën; ←

Në suaza të vazhdueshme, në kuadër të sesioneve informuese fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara janë përditësuar me situatën aktuale me **COVID-19**; ←

Në përgjigje ndaj nevojave si pasojë e **COVID-19**, **QRBB** ka ofruar pako ushqimore dhe higjienike për më shumë se 50 familje, janë shpërndarë **rreth 500 maska** dhe dhjetëra pajisje ortopedike; ←

Përgjatë këtij tre mujori, rreth **80 njerëz (45 V; 35D)** kanë përfituar nga shërbimet e ofruara nga Qendra në forma direkte apo jo direkte; ←



# Storie Suksesi



Loja, konsiderohet një nga të drejtat themelore të çdo fëmije. Përmes saj, fëmijët mësojnë rreth botës, vetes, bashkëveprojnë me të tjerët, duke zhvilluar kështu aftësitë sociale dhe motorike. Ndaj, këndi i lojërave është një hapësirë e rëndësishme e cila kontribuon në zhvillimin e fëmijëve dhe si i tillë, do duhej të ishte i qasshëm për të gjithë fëmijët.



Parku Liria, Ferizaj

/05

Këndet e lojërave që shohim në çdo park, janë plotësisht të paqasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. E prezenca e barrierave të tilla bën që fëmijët me aftësi të kufizuara të ndahen nga grupi i bashkëmoshatarëve duke ndikuar kështu ndjeshëm në aspektin e tyre emocional e duke çuar në izolim social.



Por çështje si kjo mund të rregullohen lehtësisht, madje është obligim i yni të ofrojmë hapësira të barabarta për të gjithë. E për të treguar këtë, përgjatë kësaj periudhe **HANDIKOS** me mbështetje të **Save dhe Children** dhe **SIDA** kanë ndërtuar një luhatëse të qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara e cila është vendosur në parkun Liria në Ferizaj, intervenim ky i cili ka bërë parkun të qasshëm për të gjithë.



*“Fëmijët janë pasuria  
jonë më e çmueshme!”*

*-ALBERT EINSTEIN*



# Shëndeti

*Shëndeti mendor i fëmijëve me aftësi të kufizuara*

Fëmijët me aftësi të kufizuara, ngjashëm si secili mund të përjetojnë vështirësi të ndryshme të shëndetit mendor si: ankthi, frikat e pa arsyeshme, depresioni apo gjendje të tjera.

## Si mund të kuptojmë nëse një fëmijë po përjeton vështirësi të tilla?

- Luhatje disponimi, agresivitet, mungesë durimi
- Vështirësi në koncentrim
- Ndryshime në apetit dhe gjumë
- Frikë
- Refuzim për të shkuar në shkollë
- Lagia e shtratit
- Ankesat për dhimbje barku apo koke
- Interes i ulët në aktivitetet e preferuara

I stresuar



E mërzitur

## Cilët janë faktorët e mundshëm ndikues?

Ngacmimet nga bashkëmoshtarët dhe përjashtimi social ←

Jetesa në një ambient abuzues apo neglizhues ←

Divorci i prindërve, vdekja e një personi të afërt, ndërrimi i vendbanimit etj. ←

Mungesa e mundësive të barabarta ←





I ngacmuar

## Si të ofrojmë mbështetje?

- Bisedoni me psikologun e shkollës së fëmijës rreth gjendjes së tij ←
- Ndihmoni fëmijën të mësojë shkathtësi ballafaqese ←
- Ofroni mbështetje në aktivitetet ku fëmija ka nevojë ←
- Përkrahni krijimin e raporteve sociale të fëmijës ←
- Nxitni biseda lidhur me përditshmërinë ←
- Krijoni një ambient të sigurt ←




Kur familjet, shkollat dhe komunitetet ndërmarrin hapa për të kuptuar nevojat individuale të fëmijës, fuqizojnë pikat e tyre të forta dhe ofrojnë ambiente mbështetëse dhe respektuese, fëmijët mund të maksimizojnë potencialin e tyre dhe të gëzojnë shëndet mendor të plotë.

**Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të barabartë për një të ardhme të ndritur.**



**Fëmijët me aftësi të kufizuara i bashkohen jetëve tona duke na mësuar dashuri të pakusht.**

**Ndonjëherë heronjtë e vërtetë jetojnë në zemrat e fëmijëve të vegjël të cilët luftojnë beteja të mëdha.**





Fëmijët i japin  
kuptim jetës  
tonë!

# Të drejtat

## LIGJI NR. 05/L-067 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë statusin dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor.

### Kushtet dhe kriteret për njohjen e statusit të personit paraplegjik dhe tetraplegjik:

#### SIPAS NENIT 6

**Personi që kërkon t'i njihet statusi i personit paraplegjik dhe tetraplegjik, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për përcaktimin e shkallës së dëmtimit, grupimit dhe nevojës sociale, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara, si në vijim:**

- 1.1. të jetë qytetar i Republikës së Kosovës.
- 1.2. përveç dokumentacionit mjekësor, aplikacionit duhet t'i bashkëngjitet edhe mendimi konziliar të Klinikës së Neurologjisë të QKUK-së.

**Përveç kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë edhe dokumentet e mëposhtme:**

- 2.1. formularin e plotësuar dhe të nënshkruar nga parashtuesi i kërkesës;
- 2.2. kopjen e letërnjoftimit;
- 2.3. ekstraktin e lindjes;
- 2.4. faturën e tatimit në pronë, si dhe një nga faturat e shërbimeve publike (ujit, rrymës, mbeturinave);
- 2.5. nëse parashtuesi i kërkesës është i liruar nga pagesa e tatimit dhe taksave ai është i obliguar të sjellë dëshmi për lirim nga tatimi dhe taksat;
- 2.6. aktvendimin për kujdestari, për fëmijët që parashtrohet kërkesa, pa përfaqësues ligjor



# Prindërimi

---

## KËSHILLA PËR PRINDËRIM POZITIV

---

Prindërimi pozitiv nënkupton marrëdhënien e vazhdueshme të një prindi dhe fëmijës së tij ku përfshihen: kujdesi, mësimdhënia, udhëheqja, komunikimi, sigurimi i nevojave të tyre dhe mbështetja e pakushtëzuar. Është shumë i rëndësishëm sepse si i tillë krijon një marrëdhënie më të shëndetshme prindër-fëmijë.

## Cilat janë disa nga format e prindërimit pozitiv?

### FOSHNJAT DHE FËMIJËT E VEGJËL

Foshnjat mësojnë duke parë atë që ju bëni, kështu që paraqitni shembuj për të marrë sjelljen që ju prisni.

- Krijoni ambient të sigurtë.
- Përdorini gjuhë pozitive.
- Ruajeni fjalën "Jo", për çështjet më të rëndësishme, siç është siguria.
- Inkurajoni sjelljet e duhura/dëshiruara.



---

## *FËMIJËT E MOSHËS PARASHKOLLORE PËRPIQEN TË KUPTOJNË SI DHE PSE FUNKSIONOJNË GJËRAT, NDAJ JANË SHUMË KURRESHITARË.*

- Lejoni fëmijën të bëj zgjedhje midis opsioneve të pranueshme
- Mësoni fëmijën tuaj të trajtojë të tjerët ashtu si dëshiron të trajtohet edhe ai
- Është në rregull që ndonjëherë të mos ndihet mirë e të jetë i zemëruar
- Mësoni si t'i trajtojë ndjenjat e zemërimit dhe të flasë lirshëm për to.

---

## *FËMIJËT E MOSHËS SHKOLLORE*

Fëmija tashmë fillon të kuptojë se çka është e drejtë dhe e gabuar.

- Siguroni një balancë privilegjesh dhe përgjegjësish.
- Vazhdoni të mësoni dhe modeloni durimin, kujdesin dhe respektin.
- Kaloni kohë me ta.

---

## *ADOLESHENTËT*

Adoleshentët zhvillojnë aftësi më të pavarura të vendimarrjes.

- Inkurajoni përgjegjësinë për sjelljet e tyre;
- Ofroni informata për sjelljet e juaja;
- Respektojeni privatësinë e tyre
- Pranoni dhe respektoni sukseset e tyre.

# Parandalimi i dhunës

Që fëmijët të rriten shëndetshëm, ata kanë nevojë për dashuri, ngrohtësi, mbrojtje e nganjëherë edhe për çokollata! Plotësimi i këtyre nevojave ndikon shumë në formimin e fëmijës.

Dhuna ndaj fëmijëve përfshin çdo veprim (fizik, verbal apo emocional) negativ që përdoret për t'i lënduar ata. Dhuna mund të ndodhë kudo, në shtëpi, shkollë, apo edhe në vende të tjera.

**Dhuna fizike** - lëndimi fizik dhe i qëllimshëm ndaj fëmijës (shuplaka; pickimi; shtyerja/rrëzimi; shtrëngimi; tërheqja e flokëve; grushtimi; etj.).

**Dhuna emocionale** - keqtrajtimin e vazhdueshëm emocional të fëmijës dhe përpjekjet e qëllimshme për: frikësim; tallje; fajësim; përdorim të informacioneve personale të dikujt kundër tij; poshtërim; injorim; etj.

**Neglizhimi** - mos sigurimin apo përmbushjen e nevojave themelore (fizike, emocionale, arsimore, mjekësore, etj) të një fëmije.

**Dhuna** ndikon **negativisht** edhe kur ajo nuk ndodhë direkt tek fëmijët, por kur fëmija është prezent apo dëshmitar i saj.





# Disa statistika mbi dhunën ndaj fëmijëve:

---

<sup>1</sup> Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, deri në **1 miliard fëmijë** të moshës **2-17 vjeç** kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës fizike, seksuale, emocionale apo të neglizhimit. Gjithashtu, në shumicën e vendeve të botës, çdo dy në tre fëmijë i nënshtrohen disiplinave të dhunshme nga kujdestarët e tyre<sup>2</sup>. Ndërkaq, sipas Jones me bashkëpunëtorë (2012) fëmijët me aftësi të kufizuara kanë **3.7 herë** më shumë gjasa të përjetojnë dhunë sesa fëmijët me zhvillim tipik.

Të flasësh për dhunën mund të mos jetë e lehtë! Disa mund të mendojnë se dhuna nuk është një problem i madh, apo se vetë personi është fajtor për këtë. Fëmijët asnjëherë nuk janë fajtor dhe nuk duhet ta fajësojnë veten. Mos harroni, në momentin që ju apo dikush tjetër përjeton dhunë, mos hezitoni ta raportoni atë menjëherë tek personat dhe institucionet e besueshme.



## Referencat

---

<sup>1</sup> [www.who.int/health-topics/violence-against-children](http://www.who.int/health-topics/violence-against-children)

<sup>2</sup> [data.unicef.org/topic/child-protection/violence/violent-discipline](http://data.unicef.org/topic/child-protection/violence/violent-discipline)

<sup>3</sup> [www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(12\)60692-8/fulltext](http://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(12)60692-8/fulltext)



# Hulumtime / Publikime

RAPORT HULUMTUES “STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI ÇËSHTJET E AFTËSISË SË KUFIZUAR:

## KU QËNDRON KOSOVA?”

Pikërisht lidhur me këtë çështje, gjatë vitit 2019, HANDIKOS ka realizuar një raport në kuadër të të cilit është vlerësuar legjislacioni i Kosovës nga pikëpamja e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian.



**Raporti krahason këto standarde: E drejta për jetë dhe drejtësi; Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet; Qasshmëria; Edukimi; Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizshmëria; Barazia, mos-diskriminimi (gratë dhe fëmijët); Shëndeti; Punësimi dhe kujdesi social; Pjesëmarrja publike; Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë.**

E rezultatet kanë treguar se **30.72%** e standardeve të përmendura më sipër janë të përfshira plotësisht në legjislacionin e Kosovës. Ndërkaq, qasja mbetet kategoria më sfiduese, me vetëm **6.77%** të standardeve të përfshira plotësisht në legjislacion.

# Të gjeturat e hollësishme për standardet e krahasuara mund t'i gjeni këtu:

<http://handi-kos.org/standardet-nderkombetare-mbi-ceshtjet-e-aftesise-se-kufizuar-ku-qendron-kosova/>



# Sport dhe rekreacion

Një nga të drejtat elementare është edhe e drejta për argëtim dhe sport. Kur flasim për personat me aftësi të kufizuara kjo e drejtë nuk respektohet mjaftueshëm.

Në vitin 1945 veteranët e Luftës së II-të Botërore të hospitalizuar në spitalet e Massachusetts SHBA, me vetë iniciativë filluan adaptimin e lojës së Basketbollit për personat me aftësi të kufizuara duke filluar të lozin të njëjtën lojë me karroca. Gradualisht ky sport filloi të popullarizohet duke u përhapur në Angli, Evropë dhe në mbarë globin.



Në Kosovë, që nga vitet 1999/2000 basketbolli në karroca, iniciuar nga HANDIKOS, është ndër sportet e para të aplikueshme në vend për personat me aftësi të kufizuara. Çdo vit, me mbështetje të ndryshme basketbolli në karroca është avancuar, madje janë formuar edhe gjashtë Klubet e Basketbollit.



**Përgjatë çdo viti, HANDIKOS me këto ekipe, organizon Turneun Memorial “Halit Ferizi” në nder të veprës së z. Ferizi, themelues i HANDIKOS.**



Ky produkt është financuar  
nga **Qeveria e Suedisë.**  
Përgjegjësia për përmbajtjen i  
takon tërësisht **HANDIKOS.**  
Qeveria e Suedisë jo  
domosdoshmërisht ndan të  
njëjtat pikëpamje.

Implementuar nga:



Mbështetur nga:

